



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 329 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01
Data/Datum/Date 31 05 2022

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013”), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016”) dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.05.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël.
2. Ndryshimi dhe plotësimi bëhet duke u bazuar në shkresën me rekomandimet nga ana Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 2187-3/22 të dt. 12.05.2022 dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-311/13 të dt. 12.05.2022.
3. Pas nenit 3 të vendimit bazik 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël, shtohet një nen i ri, me tekstin si në vijim:

3A. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 500 m² (pesëqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet morgu sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 pjesa prej afro 40% e parcelës është brenda kufirit ndërtimor, kurse pjesa tjetër prej afro 60% është e paraparë si tokë bujqësore klasa e bonitetit II.
4. Nërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 mbesin të pandryshuara.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren

(QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr.329/22
Datë: 31.05.2022

